



## NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e hënë, në datën 29 qershor 2020, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Shtyrjen e afatit të mbylljes së transmetimeve analoge në qarqet Elbasan, Shkodër, Lezhë dhe Vlorë, deri në datën 30 shtator 2020. (**Vendimi nr. 51, datë 29.06.2020**)
2. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “One Tv Vlora” sh.p.k., licencuar për subjektin audioviziv privat “One Tv Vlora”. (**Vendimi nr. 52, datë 29.06.2020**)
3. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në shoqërinë “Euronews Balkans” sh.p.k., licencuar për subjektin audioviziv privat “Euronews Balkans” (**Vendimi nr. 53 datë 29.06.2020**)

AMA në këtë mbledhje mori në shqyrtim dokumentin e draft Strategjisë dhe Planit të Veprimit të AMA-s për periudhën 2020-2022, u njoh me komentet dhe sugjerimet e ardhura mbi këtë draft dhe sugjeroi disa shtesa e përmirësime në tekst.

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**Tiranë, më 29 qershor 2020**